



BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE

**SHPALLJE PËR
LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN
CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(Specialist)**

**Lloji i diplomës “Ekonomik, Financë, Administrim Biznesi”
niveli minimal i diplomës “Bachelor”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II ,III,IV dhe VII të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore, Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në Shërbimin Civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet:

- 1 (një) Specialist në Sektorin e Jetësimit të Projekteve në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Projekteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik, kategoria e pagës IV-a
- 1 (një) Specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Urban në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik Urban në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik, kategoria e Pagës IV-a.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin, nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të gjitha procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE: **7 Korrik 2016**
Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NE DETYRE: **12 Korrik 2016**

1. PËRSHKRIMI PËRGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN SI MË SIPËR

1. Punon për administrimi dhe jetësimi i projekteve prioritare të Bashkisë Tiranë;
2. Merr pjesë në hartimi i planeve strategjike afat-mesme dhe afat-gjata për projektet prioritare në zhvillimin ekonomik urban të Bashkisë Tiranë;
3. Përcaktimin e hapave të nevojshme që duhen ndërmarrë dhe kalendarit të zhvillimit dhe jetësimit të projekteve të zhvillimit ekonomik urban të qytetit të Tiranës.

4. Mbikqyrja e realizimit të projekteve hap pas hapi deri në përfundimin e tyre.

1 LEVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (IV-a);
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a-Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në degët ekonomik financë, administrim biznesi.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
 - b- Fotokopje të diplomës
 - c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
 - g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
 - h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
 - i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Tiranës brenda datës **7 Korrik 2016**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **11 Korrik 2016**, njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore;
- b) Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar
- c) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”;
- d) Ligjin nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” i ndryshuar.

e) Ligji Nr. 107 /2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. PRANIMI NE SHERBIMIN CIVIL NE KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe stendat e informimit të publikut duke filluar nga data **15 Korrik 2016**.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHERBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

a- Të jetë shtetas shqiptar;

b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

g- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkenca Ekonomike Finance, Administrim Biznesi.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

a- Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat për konkurim, të listuara në piken 1.2.

- b- Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Tiranës brënda datës **12 Korrik 2016**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **15 Korrik 2016**, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe standat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në Shërbim Civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data **15 Korrik 2016**.